



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 10181 Prot

Shkodër, më 30.04.2026

VENDIM

Nr. 161 datë 30/04/2026

“PËR NJE NDRYSHIM DHE SHTESE NE VENDIMIN NR.51,DATE 13.02.2025”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 “Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjit nr.75/2019 “Për rininë”; Udhëzimi nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar; ligjit 9632 date 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; ligjit nr.79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar; ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar ne republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 ”Për sistemin e adresave” të ndryshuar; ligjit nr.8308 date 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.52, date 13.02.2026.
 2. Per nje ndryshim dhe shtese ne vendimin nr.51,date 13.02.2026 Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, znj.Teuta Qyteza me detyrë zëvendeskryetare bashkisë Shkodër;
- Për nënshkrimin e çdo shkrese që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/fizik dhe individ per:
 - Drejtorinë e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë
 - Drejtorinë e Shërbimeve Sociale
 - Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe.
 - Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik
 - Drejtorinë e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
 - Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore
 - Drejtorinë e Arsimit
 - Gjendjen Civile

- Konfirmimin e adresave të qytetareve nga sistemi.
2. Zv/Kryetarja nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
 4. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 04.05.2026 dhe përfundojnë me datë 15.05.2025, ora 16.00.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet znj. Teuta Qyteza dhe administrata bashkisë Shkodër.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

